

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

**28.04.2023
Ora 09:30**

RENDI I DITËS

**Shorti “Për caktimin e relatorit për kërkesën ankimore nr. 53, subjekti ankues
Koalicioni Bashkë Fitojmë”.**

PJESËMARRJA :

**KAS: Z.Elvin LAKO, Z.Elvis Çefa, Z.Ilirjan RUSMALI ,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO**

Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, Znj. I. Osmanaj

Parti Politike:

Të tjerë: KRIIK

Z. Y. Merkaj: Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Sot në datën 28 prill 2023, ora 09:30 hidhet shorti për caktimin e relatorit, kërkesë ankimore numër 53, me ankues Koalicioni Bashkë Fitojmë, i cili kundërshton kundërshton vendimin e Komisionerit Shtetëror të zgjedhjeve numër 404, datë 24.04.2023 për caktimin e partisë politike, që do të propozojë anëtarin e tretë dhe të katërt, të grupeve të numërimit, për zgjedhjet për organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023. Nryshimin e vendimit duke përcaktuar Partinë e Lirisë, një parti politike që i lindë e drejta propozimit të anëtarit të katërt të grupit të numërimit të votave, për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Procedur e shortit është përcaktuar ,referuar nenit 14 rregullores së KAS-it, për këtë kemi përgatitur 5 shirita letre ku në një të është shënuar kërkesa ankimore numër 53, 4 shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime, të cilat vendosen në gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë, në një

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

enë transparente. Duke qënë se anëtarët e KAS-it nuk janë të pranishëm në procedurën e shortit, kanë dhënë autorizimin për të tërhequr në emër dhe për llogari të tyre një përfaqësues të KQZ-së duke filluar nga rendi alfabetik të emrit rritës, duke filluar me zotin Ervin Lako të parin, Elvis Çefa, Ilirjan Rusmaili, Koli Bele dhe në fund Ledio Braho. Të 5- të gogla janë në një enë transparente pasi përzihet nga një përfaqësues i KQZ-së.

-Tërhiqet gogla e parë -Vazhdojmë në emër dhe llogari te:

Z. E. Lako: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

-Vazhdojmë në emër dhe llogari te:

Z. E. Çefa: -Kërkesa ankimore numër 53.

-Vazhdojmë në emër dhe llogari te:

Z. I. Rusmaili: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Vazhdojmë në emër dhe llogari te:

Z. K. Bele: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

-Vazhdojmë në fund, në emër dhe llogari të:

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

Z. Ledio Braho: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Në përfundim të procedurës së shortit kërkesa ankimore numër 53 do të ketë relator zotin Elvis Çefa, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

**28.04.2023
Ora 10:12**

RENDI I DITËS

Projektakti "Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 52, me objekt "Shfuqizimi i vendimit nr. 32, 33, 58, 42, 46, 47, 48, 51, 52, 54, 55, datë 24. 4. 2023 te KZAZ nr.17, "Për emërimin e anëtarëve të Komisionit të Qendrës së Votimit nr. 0939, nr. 0941, nr. 0943, nr. 0993, nr. 0997, nr. 0998, nr. 0998/1, nr. 1002, nr. 1003, nr. 1025 dhe nr. 1026, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore", me ankues Partia Socialiste e Shqipërisë dega Klos, përfaqësuar nga z. Armand Gjini."

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI(online),
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, Znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** PDIU, BF
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. E. Lako: Atëherë, çelim sot seancën publike të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve për verifikimin e plotësimit të elementëve të formës dhe të përmbatjes për kërkesën ankimore nr.52 të paraqitur nga dega Klos e Partisë Socialiste të Shqipërisë me objekt shfuqëzimin e vendimeve nr.32, 33, 58, 42,46, 47, 48,51, 52, 54. 55 të datës 24.4.2023 të KZAZ nr.17 për emërimin e anëtarëve të Komisionit të Qendrës së Votimit nr.0939, 0941, 0943, 0993, 0997, 0998,0998/1, 1002, 1003,1025, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023. Relator i kësaj seance jam zgjedhur unë Elvin Lako sipas shortit të hedhur në datën

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

27.04. 2023. Të pranishëm në seancë janë anëtarët e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve përveç zotit Rusmali që është duke na ndjekur online.

Z. I. Rusmali: Përshëndetje të gjithëve!

Z. E. Lako: Përshëndetje zoti Rusmali! Janë anëtarët, janë përfaqësuesit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Sekretari i Përgjithshëm dhe administrata. Gjithashtu ju lutem përfaqësuesit e ankuesit e Partisë Socialiste dega Klos ka njeri?

Z. Aderit Pjetri: Jam i autorizuar për të përfaqësuar degën Klos në këtë seancë.

Z. E. Lako: E keni dorëzuar Autorizimin?

Z. Aderit Pjetri: Po.

Z. E. Lako: Pra, autorizimin ju e keni nga dega Klos. E keni administruar ju administrata. Po kemi palë të interesuara?

Z. Mehmet Luani: Kryetari i KZAZ-së nr.17 Klos, përfaqësues i Partisë Demokratike.

Z. E. Lako: Keni bërë kërkesë për të qenë si palë e interesuar .

Z. Mehmet Luani: Jo, jo e marim për shkak të vendimit.

Z. E. Lako: Atëhere, ju jeni kryetari i KZAZ-së. Juve?

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

Znj. Dorina Mirdita: Sekretare e KZAZ nr.17, e propozuar nga Partia Socialiste për të qenë sekretare.

Z. Ylli Topalli: Anëtar i KZAZ-së

Z. E. Lako: Po, ju të tre keni ardhur. Mirë faleminderit! Zoti Sekretar i Përgjithshëm shumë shkurtimisht ju lutem për çfarë është objekti i ankimit.

Z. Y. Merkaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore nga Partia Socialiste dega Klos e cila kërkon shfuqëzimin e vendimit nr.32, 33, 58, 42,46,47,48,51,52,54,55 datë 24.4.2023 të Komisionit Zonal të Administrimit Zgjedhor nr.17 Bashkia Klos për emërimin e anëtarëve të Komisionit të Qendrës së Votimit nr.939,941, 943,993,997,998,998/1002,1003,1025,1026 për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023. Nga verifikimi paraprak i kërkesës ankimore konstatohet se nuk plotëson elementët formal të nenit 130 të Kodit Zgjedhor dhe konkretisht legjitimin e ankuesit pasi nuk legjitimohet në ngritjen e kësaj kërkesë. Elementet e tjerë kompetencë e KQZ-së plotësohen dhe respektimi i afatit plotësohet. Duke qenë se një nga elementët nuk plotësohet kërkojmë të mos kalohet në seancë publike për shqyrtimin, faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit zoti Sekretar i Përgjithshëm! Atëherë ankuesi shkurtimisht ju lutem në lidhje me plotësimin elementëve të formës dhe të përmbatjes. Pra, a është KAS organi kompetent për të shqyrtuar këtë ankim? A është bërë brenda afatit ligjor? A legjitimoheni ju për të bërë ankimin? Cili është interesi i ligjshëm në këtë rast?

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*


Domethënë do flasim në lidhje me elementët e formës dhe të përmbatjes jo për shqyrtimin në themel të çështjes.

Z. A. Pjetri, përfaqësues i PS dega Klos: Duke parë kontekstin edhe ngërçin që është krijuar në KZAZ-në numër 17 ne e kemi parë të arsyeshme dhe të ligjshme që ta paraqesim këtë ankimim në KAS. Kjo për shkak se dega Klos ka vizionin për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut të garantuara nga hierarkia dhe burimet e së drejtës si dhe në frymën e zbatimit të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Veçanërisht normat që rregullojnë procesin zgjedhor e parashtrajmë këtë ankim lidhur me vendimmarrjen që e konsiderojmë në shkelje flagrante të ligjit zgjedhor dhe akteve nënligjore në fuqi. Përmes përfaqësuesve të kësaj KZAZnr.17 jemi më venë në dijeni se me datën 24.04.2023 është marrë vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit të Qendrës së Votimit për zonat përkatëse si vijon më poshtë;939, 941, 943, 993, 997,998,998/1002,1003,1025,1026. Shkeljet e pretenduara ...

Z. E. Lako: Ju lutem edhe njëherë! Nuk do të diskutojmë shkeljet do të diskutojmë legjitimitimin e kësaj seance për ta futur në proces çështjen. Që do të thotë a keni të drejtë ju të bëni ankim, a është bërë konformë ligjit ankimi? Për elementët e formës dhe të përmbatjes. Shkurtimisht pse ju legjitimoheni për të bërë këtë ankim dhe a është bërë konformë ligjit ankimi brenda afatit ligjor a ka KAS kompetencë për ta shqyrtuar? Shkurtimisht, nëse kjo do kalojë në seancë pastaj do diskutojmë në themelin e çështjes.

Z. A. Pjetri, përfaqësues i PS dega Klos:Patjetër që dega Klos ka të drejtë ta ngrejë këtë ankimim e aq më tepër në KAS duke qenë se KZAZ nr.17 ka pasur këtë konflikt,

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

atje, këtë paligjshmëri duke qenë se zonat që kanë një KZAZ miratojnë listën shumëmemërore por në një rast hipotetik në Bashkinë e Tiranës që kanë më shumë se një KZAZ, automatikisht është komisioni zgjedhor që miraton këto lista shumëmemërore. Pra, kjo është arsyetimi pse ankimimi ka ardhur në KAS për të...

Z. E. Lako: Më falni që po ju ndërpres, nëse nuk keni gjë për të thënë edhe mund të mos thoni gjë. Por me çfarë u diskutua këtu, çfarë tha edhe zoti Sekretar i Përgjithshëm, pra nga ajo çfarë ka konstatuar administrata janë plotësuar elementët e afateve, organi të cilit i drejtohet, pra KAS është kompetent për shqyrtimin e çështjeve të KZAZ-së por po diskutojmë për legjitimitimin. Domethënë a ka të drejtë dega Klos e Partisë Socialiste të bëjë ankim në emër të bëj ankim në emër të subjektit zgjedhor Partia Socialiste? Ju mendoni që ka?

Z. A. Pjetri, përfaqësues i PS dega Klos:Po.

Z. E. Lako:Gjë tjetër keni për të shtuar?

Z. A. Pjetri, përfaqësues i PS dega Klos: Jo.

Z. E. Lako: Për palën e interesuar për KZAZ-në, shkurtimisht nëse keni diçka për të thënë? Për këtë pjesë?

Z. M. Luani, kryetari i KZAZ-së nr.17 Klos: Atëherë, të nderuar anëtarë nuk jam dakord me atë çfarë parashtrori përfaqësuesi i Partisë Socialiste. Ne kemi zbatuar në mënyrë rigoroze ligjin dhe aftët që i parashikon Kodi Zgjedhor. Kemi miratuar KQV-të brenda afatit disa ditë, me shumicë votash 4 me 3 për 11 komisione kanë

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

votuar kundër për një ardye që thonë këto persona gjenden në listat shumemërore për këshilla bashkiak. Ne paraprakisht i kemi verifikuar i kemi gjetur në listat e këshillave bashkiak, ua kemi rikthyer për plotësim dokumentacioni subjekteve politike dhe brenda afateve kemi marrë një vendim dhe partitë politike na kanë paraqitur dorëheqjen e këtyre personave që ndodhen në listat shumemërore të listave për këshillin bashkiak. Besoj që ne jemi në përputhshmëri me ligjin...

Z. E. Lako: Më fal këto i përkasin themelit.

Z. M. Luani, kryetari i KZAZ-së nr.17 Klos: Këto dorëheqje janë depozituar edhe pranë institucionit të KQZ-së. Se unë besoj që nuk kemi asnjë lloj shkelje ligjore për çështjen si për afatet ne çështjen e konfliktit të interesit të këtyre personave.

Z. E. Lako: Gjatë shqyrtimit të çështjes në themel nëse kjo do të kalojë. Për këtë pjesën e shqyrtimit paraprakë të çështjes keni ndonjë koment? Për legjitimitimin e ankuesit?

Z. M. Luani, kryetari i KZAZ-së nr.17 Klos: Për mua është i padrejtë.

Z. E. Lako: Në rregull, faleminderit! Do flasi dikush tjetër nga KZAZ, ka ndonjë diçka për të shtuar? Nuk keni! Pyetje nga anëtarët e KAS? Zoti Braho?

Z. L. Braho: Kam një pyetje për të dyja palët. Megjithatë pyetjen e parë e kam për përfaqësuesit e ankuesit. Keni ndonjë autorizim nga subjekti zgjedhor që është Partia Socialiste e Shqipërisë që ju mund të ankimoni vendimmarrjet e KZAZ-ve si degë e Partisë Socialiste?

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

Z. A. Pjetri, përfaqësues i PS dega Klos: Për sa kohë që Partia Socialiste me ka dhënë të drejtën që unë të depozitojë anëtarët dhe komisionerët për Partinë Socialiste në KZAZ-në nr.17 besoj se kam të drejtë edhe të ankimojë edhe problematikat që më kanë vënë në dijeni dy anëtarët e mi të partisë.

Z. L. Braho:E ke autorizimin me vete? Autorizimin që ke përdorur.

Z. A. Gjini, Kryetar i PS dega Klos:Unë sot me vete nuk e kam por do tua depozitojë sa ta kem në telefon. I kam depozituar edhe në KZAZ të dy autorizimet që mi ka dhënë Kryetari i Partisë Socialiste zoti Edi Rama.

Z. K. Bele:Më fal për të njëjtin subjekt, këtu ka një praktikë që ta dini, që partitë politike përfaqësohen ose nga vetë struktura qendrore e cila ka një përfaqësues permanent në KQZ kjo vlenë për Partinë Socialiste, Demokratike, krejt partitë që kur nuk mbahet mend që kur i ndjek unë zgjedhjet ose përjashtimisht nëse partia i jep autorizim një personi, një pale, një kryetari dege, një avokati apo dikujt tjetër. Por partinë si subjekt politik duhet një autoriz i posaçëm. E kuptpje po pratisia ka 61 degë sot, dikur ka qenë 378 komuna dhe janë më duket 100 KZAZ, atë autorizim për të depozituar komisioner apo anëtarë KZAZ mund ta kenë edhe më shumë veta se aq. Në një bashki mund ta kenë dy veta. Pyetja që kemi ne sot, e kemi një autorizim të pocsaçëm që të jep të drejtën për të ngritur padi në emër të subjektit politik se këtu vjen Dega Klos, Dega Klos nuk është subjekt zgjedhor. Subjekti zgjedhor është Partia Socialiste ose Partia Demokratike ose kushdo parti tjetëri. Degët janë nëndarje të partisë që veprojnë në territor si ta çmojë partia , mund ta ndajë në degë, mund ta ndajë në rajone, mund ta ndajë në njësi më të vogla më të

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

mëdha. Pra, pyetja jonë ishte kjo. A keni një autorizim të posaçëm, nuk e si ju besoj jeni jurist dhe e kuptoni gjuhën që flasim që ju jep tagrin për të përfaqësuar Partinë Socialiste të Shqipërisë. Pra, ju sot keni ardhur në emër të Partisë Socialiste të Shqipërisë, nuk është subjekt zgjedhor Dega Klos.

Z. A. Pjetri, përfaqësues i PS dega Klos: Atëherë, duke qenë kusht në kërkojmë shtyrjen për të sjellë një autorizim specifik siç ju e kërkon.

Z. E. Lako: Po zoti Çefa!

Z. E. Çefa: Tani që të jemi të qartë autorizimi nënkupton që ti duhet të ishe i autorizuar ndërkohë që ke nënshkruar kërkesën. Që domethënë sot marrja e autorizimit sot me datën e sotme nuk ka efekt prapaveprues në kohë, nuk të autorizon ty që para dy ditëve apo një dite kur ke firmosur kërkesën me të cilën ke vënë në lëvizje gjithë këtë proces edhe në ndërkohë ta bësh këtë. Prandaj autorizimi i marrë tani nuk vlen. Nëse ju e keni pasur këtë autorizim të nënshkruar më dëgjoni me vëmendje nëse e keni pasur të nënshkruar përpara se të firmosnit kërkesën ankimore për në KAS. Atëherë, ne po të presim pak që të na e sjellësh, nëse nuk e ke kështu atëherë edhe për ekonomi tonën administrative edhe tuajën na e thuaj që të mos humbim kohë.

Z. E. Lako: Sipas procedurës në momentin që vini në seancë duhet ti keni me vete provat dhe kjo është një provë që duhet të ekzistojë siç tha edhe kolegu Çefa duhet ta kishit në momentin kur keni bërë ankimin. Tani shkurtimisht edhe njëherë, çfarë kërkon nga KAS me rradhë kërkuesi, shkurtimisht që të kalojë për seancë kjo të shqyrtohet apo mos të kalojë.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

Z. A. Gjini, Kryetar i PS dega Klos: Të zbatohet rregullorja e KQZ-së për çdo anëtar, të mos ketë lidhje familjare në vendet e asaj... Kjo është ajo që kërkojë unë. Dhe nuk më duket e drejtë që pasi është plotësuar lista për anëtarë këshilli të japin dorëhiqen para se të hynë në zgjedhje.

Z. E. Lako: Për palën e interesuar çfarë kërkon nga KAS?

Z. A. Gjini, Kryetar i PS dega Klos: Dhe nuk më duket e drejtë që pasi është plotësuar lista për anëtarë këshilli të japin dorëheqen para se të hynë në zgjedhje.

Z. E. Lako: Kjo është për themelin. Jemi tek çështja për legjitimimin e çështjes për ta shqyrtuar apo jo KAS. Ju mendoni që legjitimoheni dhe kjo çështje duhet të shqyrtohet nga KAS. Për palën e interesuar çfarë mendimi keni?

Z. M. Luani, kryetari i KZAZ-së nr.17 Klos: Ne kërkojmë që këto vendime të miratohen se janë në përputhshmëri me ligjin sepse të gjithë kanë paraqitur kërkesë nga lista shumemërore. Për korrektësi janë lista nga numri 10 deri në numrin 20 që nuk kanë asnjë lloj. Këto kërkesa janë depozituar në KQZ në qoftë se KQZ merr vendim që këto të dorëhiqen bie çdo gjë poshtë nuk ka nevojë të bëjmë as gjyqje as... Këtu paligjshmëria është e Partisë Socialiste që nuk ka as autorizim këtu sot.. Jo ne, ne jemi në përputhshmëri të plotë me ligjin. Të gjithë këto kandidatë dhanë dorëheqjen kanë të drejtë gjithësecili ka të drejtë të kandidojë dhe të tërhiqet.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

Z. E. Lako: Kjo ka të bëjë me themelin. E sqarova disa herë, jemi në shqyrtimin paraprakë. Pra, ju mendoni që legjitimohet apo jo ankuesi në kërkesën e vetë po apo jo?

Z. M. Luani, kryetari i KZAZ-së nr.17 Klos: Jo.

Z. E. Lako: Atëherë zoti Rusmali nëse na dëgjon keni ndonjë pyetje?

Z. I. Rusmali: Jo nuk kam pyetje.


Z. E. Lako: Zoti Sekretar i Përgjithshëm diçka të fundit edhe për ta mbyllur.

Z. Y. Merkaj: I qendrojmë kërkesës për të mos e kaluar në seancë.

Z. E. Lako: Për të mos kaluar. Ju kishit diçka, vetëm shkurtimisht!

Znj. D. Mirdita, sekretare e KZAZ nr.17: Vetëm diçka për të sqaruar normalisht Kryetari i partisë dega Klos është paraqitur pranë zyrës ose më saktë KZAZ nr.17 për dorëzimin e dokumentacionit në mënyrë të detyrueshme nga ligji ka paraqitur edhe autorizimet përkatëse për çdo procedurë që e ka kryer përpara KZAZ nr.17. Për të qenë sa më të ndërgjigjshëm si me veten ashtu dhe me ligjin kërkoj hapësirë kohore të paktën vetëm verifikimin e autorizimit që unë kam pranë zyrës për këtë pjesë. E ndjej detyrim moral dhe profesional që kjo pjesë të bëhet verifikimi i autorizimit që ne kemi në zyrë.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

Z. E. Lako: Patjetër ne do të tërhiqemi për vendim dhe do tu krijojmë një hapësirë 10-15 minuta duke pasur parasysh që kemi edhe çështje të tjera në rradhë për tu shqyrtuar që të presim që ju të na e vini atë autorizim në dispozicion dhe pastaj do shpallim vendimin. Do ju thërrasim 10-15 minuta.

Rifillon Mbledhja ora 11:27

Z. E. Lako: Atëhere, riçelim seancën për kërkesën ankimore nr.52. Në përfundim në mbështetje të nenit 129 pika 3 shkronja b të ligjit 1019 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë KAS vendos: 1. Mos pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr.52 datë 26.04.2023 të paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë Dega Klos për shkak të mos legjitimitit të subjektit ankues. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve . Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga shpallja e tij. Faleminderit!

Vendimi nr. 67

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

**28.04.2023
Ora 10:42**

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 53, subjekti
ankues Partia e Lirisë”..**

- **PJESËMARRJA :**
- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis Çefa, Z.Ilirjan RUSMALI (online)
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, Znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** PDIU, BF
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve, atëherë fillojmë seancën e shqyrtimit paraprak të elementëve të formës dhe të përmbajtjes, të kërkesës ankimore me numër 53, e regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në datë 27 prill 2023, me subjekt ankimues koalicionin zgjedhor Bashkë Fitojmë përfaqësuar nga Partia e Lirisë, me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me numër 404, datë 24 prill 2023, për caktimin e partive politike, që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave për zgjedhjet, nga organet e qeverisjes vendore 14 maj 2023. Ndryshimin e këtij vendimi duke përcaktuar Partinë e Lirisë, si parti që i lind e drejta propozimit të anëtarit të katërt, të grupeve të numërimit të votave për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Sipas shortit të hedhur në KQZ, relator i kësaj çështje jam

1

**Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI**

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

caktuar unë Elvis Çefa. Verifikojmë fillimisht pjesëmarrjen, është në prezencë trupa e plotë e KAS-it duke përfshirë dhe kolegun Rusmaili, i cili për arsye të pamundësis objektive nuk është prezent në këtë seanc por po na ndjek, pra është prezent online, është prezent administrata e KQZ-së, e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe stafi i tij. Është prezent përfaqësuesi i ankimuesit, zoti Franci Nuri.

Z. F. Nuri: Po i nderuar, prezent.

Z. E. Çefa: Faleminderit, është prezent gjithashtu edhe ...

Z. K. Xhemali: Përfaqësuesi PDIU-së Klardi Xhemali.

Z. E. Çefa: Autorizimin e keni dorzuar në ...?


Z. K. Xhemali: Po i nderuar, kemi autorizim.

Z. E. Çefa: Në rregull, pra mund të vijojm shkurtimisht, me pyetjen sipas protokollit . Nëse kemi ndonjë deklaratë paraprake lidhur me përbërjen e trupës së KAS-it?

Z. F. Nuri: Jo i nderuar, asnjë kundërshtim, nuk kemi.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Kolegët ndonjë kërkesë?

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

Z. I. Rusmali: Jo.

Z. E. Çefa: Faleminderit, zoti Rusmaili. Atëhere mund të vijojmë shkurtimisht, ia jap fjalën përfaqësuesit të ankimuesit zotit Franci Nuri, për elementët e formës dhe përmbajtjes.

Z. F. Nuri: Faleminderit zoti Çefa, atëherë në lidhje me këtë kërkesë ankimore, ne duam të shprehim dhe një herë duke nisur nga elementët formal konsideratën tonë. Ky ankimim, është depozituar brenda afateve ligjore të parashikuara nga Kodi Zgjedhor neni 125 i tij, vendimi i Komisionerit numër 404, është marrë në datë 24 prill 2023, dhe ne si koalicion përfaqësuar nga Partia e Lirisë e kemi depozituar ankimimin në datë 27 prill, vendimi i atakuar na cënon në të drejtat tona si koalicion, ku përfshihet Partia e Lirisë subjekti zgjedhor. Për shkak të shpërndarjes së anëtarit të tretë, edhe të katërt të GNV-ve (grupeve të numërimit të votave). Së pari nuk janë marrë në konsideratë, nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve kërkesat tona, të shprehura nga përfaqësuesi jonë gjatë seancës publike të mbajtur në datë 24, pra na janë cënuar të drejtat dhe janë anuluar të drejtat tona ,në lidhje me përfaqësimin, me numërusët, me GNV-të, në të gjithë Republikën. Pa i hyrë elementëve të thelbit, që do të jenë objekt shqyrtimi shpresojmë më vonë. Ne kërkojmë që të legjitimohemi si palë, për shqyrtimin e kësaj kërkesë ankimore në themel, ku do të diskutjmë më gjërsisht edhe elementët e tjerë të kërkesës, pra kërkojmë që të pranohet kërkesa jonë.

Z. E.Çefa: Faleminderit zoti Nuri, po përfaqësuesi i PDIU-së. Diçka për këtë element? Pa i hyrë themelit të lutëm.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

Z. K. Xhemali: Po i nderuar, për sa i përket kërkesës ankimore, po konstatoj që ka firmosur dhe e ka bërë këtë kërkesë përfaqësuesi i Koalicionit Bashkë Fitojmë. Ndërkohë akti për të cilin kundërshtohet është me Partinë e Lirisë, pra mendojmë që duhet të ishte Partia e Lirisë nëse do të kishte ankesa. Ky është një pretendim për legjitimim, mendoj që ju duhet ta shqyrtoni këtë sepse pavarësisht se ata janë në një koalicion, por subjekti është Partia e Lirisë, nuk është subjekti Zgjedhor Bashkë Fitojmë, edhe këtu është firmosur dhe thotë Koalicioni Bashkë Fitojmë, pra ankimuesi dhe në fund pavarësisht se ka vulën e Partisë së Lirisë, thotë Koalicioni Bashkë Fitojmë përfaqësuar nga përfaqësuesi Altin Kaziaj.

Z. E. Çefa: Pra ju mendoni që nuk legjitimohet koalicioni në këtë ankim.

Z. K. Xhemali: Nuk ka legjitimim për ta bërë këtë.

Z. F. Nuri: Po i nderuar faleminderit, një saktësim, jo vetëm në fund e kemi saktësuar edhe në fillim të ankesës që është Koalicioni Bashkë Fitojmë, BF me iniciale, përfaqësuar nga Partia e Lirisë, është vendosur dhe në fillim dhe kudo në tekst nuk e kemi mohuar këtë gjë, nuk është se ka dal vetëm në fund, thjesht për sqarim, është vendosur që në fillim. Përderisa subjekti është i përfshirë në koalicion nuk ka rrugëzgjidhje tjetër, edhe aq më tepër, që personi tjetër që e ka nënshkruar ka autorizimin nga Partia e Lirisë, plus që dihet botërisht, që është përfaqësuesi i Partisë së Lirisë në vetëvete, faleminderit.

Z. E. Çefa: Dakord faleminderit. Po edhe diçka tjetër?

Zbardhi materialin audio

Jonida KOCAQI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

Z. K. Xhemali: Partia e Lirisë, njhet si partia udhëheqëse e koalicionit. Por janë dy subjekte të ndryshme mendojmë ne. Që do të thotë Bashkë Fitojmë dhe Partia e Lirisë janë subjekte të ndryshme dhe nuk mund të ketë tanger legjitimimi një subjekt tjetër për një subjekt tjetër, ky ishte qëndrimi thjeshtë për sqarim.

Z. E. Çefa: Faleminderit, të dëgjojmë edhe Sekretarin e Përgjithshëm atëherë të KQZ-së, çfarë opinion ka edhe ai.

Z. Y. Merkaçaj: Nga verifikimi i elementëve formal të kërkesës ankimore numër 53, konstatohet se i plotëson kërkesat e parashikuara të nenit 130, të Kodit Zgjedho. Kompetencën e KQZ-së për të marrë në shqyrtim këtë çështje është në rastin konkretë KAS-i, i cili ka kompetencë për të shqyrtuar vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, legjitimimin e ankuesit, plotësohet pasi ka interes të ligjshëm për caktimin e anëtarit të katërt, të grupit të numërimit dhe ka respektuar afatin ligjor të ankimit, është ne datë 24, është dhënë vendimi në datën 27 brenda tre ditëve nga afati i ankimit. Kështu që kërkojmë që te kaloj në seancë për shqyrtim, faleminderit.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit, atëherë nëse ka pyetje nga kolegët, duke filluar nga zoti Rusmaili meqënëse është...

Z. I. Rusmali: Jo, nuk kam pyetje.

Z. E. Çefa: Atëherë faleminderit, po Ledio.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

Z. L. Braho: Kisha një pyetje për zotin Nuri. Zoti Nuri, është gabim material sipas jush që ankimues është konsideruar koalicioni dhe jo Partia e Lirisë? Meqënëse thatë që elementët e tjerë janë të gjitha që i takojnë Partisë së Lirisë. Është gabim material në hartimin e kërkesës ankimore?

Z. F. Nuri: Në dijenin time nuk duhet të ketë ndonjë gabim material, nuk jam marrë unë personalisht me hartimin e kësaj kërkesë, por patjetër që është Partia e Lirisë që përfaqëson ,sikundër edhe KAS-i ka vendosur që në një farë mënyre është ajo kryesuesja e koalicionit në të gjithë aspektet.

Z. I. Rusmali: Pra ju i qëndroni ides që ankimues është subjekti Bashkë Fitojmë jo Partia e Lirisë?

Z. F. Nuri: Koalicioni Bashkë Fitojmë përfaqësuar nga Partia e Lirisë.

Z. K. Xhemali: Në lidhje me pyetjen që bëri i nderuar anëtar i KAS-it të paktën ne që jemi në përfaqësim tërë kohës, ka përfaqësues të tjerë subjekti Bashkë Fitojmë, këtë mund ta verifikojë dhe KQZ-ja, ka përfaqësues të tjerë subjekti Partia e Lirisë, me autorizime.

Z. E. Çefa: Dakord, atëherë ne do ta mbyllim këtu seancën, do të kemi pak minuta konsultë brenda KAS-it, edhe do të ju njoftojmë për të shpallur vendimin, faleminderit.

**Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

Rifillon Mbledhja ora11:28

Z. E. Çefa: Riçelim seancën për sa i përket shqyrtimit të shqyrtimit të elementëve procedural dhe formal të kërkesës ankimore nr.53. Duke qenë se përfaqësuesi i palës ankuese ka kërkuar të bëjë një sqarim përpara se të shpallim vendimin. Po ia japim edhe njëherë fjalën zoti Nuri!

Z.F. Nuri, përfaqësues i koalicionit BF: Faleminderit e nderuar pas konsultimeve edhe me përfaqësuesit e tjerë, duke qenë se siç e theksova dhe në seance nuk isha unë ai që e kisha hartuar kërkesën. Është bërë një gabim material në kërkesën tonë dhe i qendrojmë që kërkesën e parashtron Partia e Lirisë.

Z. E. Çefa: Pra, kërkesa është e nënshkruar në emër të Partisë së Lirisë.


Z.F. Nuri, përfaqësues i koalicionit BF: Po është në emër të Partisë së Lirisë siç kundër është e nënshkruar nga zoti Kaziaj përfaqësuesi i Partisë së Lirisë dhe me vulë të Partisë së Lirisë kjo është evidente. Kështu që më lejoni që të depozitojë .

Z. E. Çefa: Ju kërkoni që ta konsiderojmë se gabim material faqen e parë të ankimit?

Z.F. Nuri përfaqësues i koalicionit BF: Po i nderuar.

Z. E. Çefa: Dakord faleminderit!

**Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

Z.F. Nuri, përfaqësues i koalicionit BF: Fleminderit!

Z. E. Çefa: Atëhere, KAS i konsultuar në vend, vendosi që bazuar edhe sigurisht në sqarimet e palës ankuese të kalojë për shqyrtim kërkesën ankimore nr.53 me subjekt ankimues Partia e Lirisë dhe me onjekt kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.404 datë 24.042023. Seanca do të zhvillohet ditën e Martë në orën 12 e 30. Me kaq seancën e deklarojmë të mbyllur.

Vendimi nr. 68

**Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

**28.04.2023
Ora 11:38**

RENDI I DITËS

“Shqyrtim paraprak i kërkesës numër 16 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Koli BELE, Z. Ledio BRAHO.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj.
- **Të tjerë:** S’ka

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve edhe njëherë. Çelim seancën për shqyrtimin paraprak të shqyrtimit të formës dhe të përmbajtjes të kërkesës numër 16 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Me objekt kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të prefekturës së qarkut Korçë, gjobë në masën 5,000 lek. Personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Belsh, gjobë në masën 5,000 lek. Personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Gjirokastrë, gjobë në masën 5,000 lek. Personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Kavajë, gjobë në masën 5,000 lek. Sipas shortit të hedhur dje në KQZ relator i kësaj kërkesë jam caktuar unë, Elvis Çefa. Fillimisht verifikojmë prezencën e palëve, është prezent trupa e KAS-it në përbërje të katër anëtarëve në këtë kuptim nuk ka asnjëlloj pengese procedurale për të zhvilluar shqyrtimin e kërkesës. Është prezent Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së bashkë me stafin e tij që në këtë procedim administrativ do të përfaqësojë Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve. Nga kolegët ndonjë kërkesë paraprake nuk ka. Në këtë kuptim mund të fillojmë menjëherë me

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

relatimin shkurtimisht të kërkesës së Komisionerit nga Sekretari i Përgjithshëm. Zoti Merkaj, fjala për ju!

Z. Y. Merkaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marë në shqyrtim disa denoncime nga 11 organizata për veprimtari publike, nga katër institucione të cilat pretendojnë se nuk janë raportuar në faqen e dedikuar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në përfundim të këtij procesi administrativ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duke parë që personat përgjegjës për raportimin e veprimtarive të ndaluara nuk e kanë kryer këtë detyrim. Kështu që ka arritur në përfundimin që kanë shkelur nenin 92 dhe 91 të Kodit Zgjedhor dhe në këto kushte i është drejtuar KAS-it (Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve) për marrjen e masave administrative për personat përgjegjës për raportimin ose më mirë për mosraportimin e veprimtarive publike.

- Prefekturës Korçë në masën 5,000 lek, personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Belsh, gjobë në masën 5,000 lek.
- Personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Gjirokastrë, gjobë në masën 5,000 lek.
- Personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Kavajë, gjobë në masën 5,000 lek. Duke qenë se nuk i kanë raportuar këto veprimtari ku kanë pasur detyrim për ti raportuar, në këto kushte KQZ i është drejtuar KAS-it për marrjen e masave administrative, faleminderit.

Z. E. Çefa: Faleminderit zoti Merkaj! Atëherë KAS i konsultuar në vend vendosi kalimin për shqyrtim të kërkesës së Komisionerit me numër 16, për vendosjen sanksioni administrativ. Seanca e themelit e kësaj kërkesë do të zhvillohet ditën e

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

martë, në datën 2 maj në orën 12:30. Me kaq këtë seancë e deklarojmë të mbyllur.
Faleminderit.

Vendin nr.69

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

28.04.2023

Ora 11:42

RENDI I DITËS

“Shqyrtim paraprak i kërkesës numër 17 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema
- **Të tjerë:** Komiteti Shqipëtar i Helsinkit

Z. L. Braho: Atëherë çelim seancën e shqyrtimit të elementëve të formës dhe të përmbajtjes të kërkesës numër 17 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të datës 26.04.2023. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i është drejtuar KAS-it në lidhje me një kërkesë në bazë të së cilës ka kërkuar vendosjen e sanksionit administrativ ndaj Kryetarit të Bashkisë Korçë gjobë në masën 10,000 lek dhe personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Korçë, gjobe në masën 5,000 lek. Të pranishëm janë trupa e KAS-it e përbërë nga katër anëtarë, për shkaqe objektive mungon zoti Ilirjan Rusmali. Grupi konsiderohet i plotësuar. I pranishëm është përfaqësuesi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, zoti Ylli Merkaj, Sekretar i Përgjithshëm i KQZ-së. Janë njoftuar edhe palët të cilat nuk janë të pranishme. Po ashtu të pranishëm janë edhe përfaqësues, denoncues nga Komiteti i Helsinkit. Ndërkohë që si Kryetari i Bashkisë dhe si personi përgjegjës apo përfaqësues të tyre nuk janë të pranishëm. Atëhere i japim fjalën përfaqësuesit të KQZ-së në lidhje me elementët e formës dhe të përmbajtjes të kësaj kërkesë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.28.04.2023*

Z. Y. Merkaj: Atëhere pranë ndërfaqes së KQZ-së për raportimet e veprimtarive, Bashkia Korçë ka raportuar një veprimtari e cila zhvillohej nga ky institucion. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin numër 231, datë 31 mars 2023 ka vendosur ndalimin e zhvillimit të kësaj veprimtarie me karakter publik të Bashkisë Korçë. Në kundërshtim me urdhërimet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve edhe me denoncim të shoqatës së Komitetit Shqipëtar të Helsinkit dhe Qëndresa Qytetare është marrë në shqyrtim administrativ denoncimi dhe në përfundim të këtij shqyrtimi administrativ Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur të propozojë:

- Marrjen e masave administrative, sanksione në masën 10,000 lek për Kryetarin e Bashkisë Korçë.

- Dhe personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Korçë në masën 5,000 lek.

Duke parë edhe elementët formal të kërkesës mendojmë që i plotëson elementët të parashikuar në nenin 130 të Kodit Zgjedhor duke qenë se e plotëson 3 elementët kopetencën, legjitimimin dhe afatin e ankimit. Kërkojmë që të kalojë në shqyrtim, faleminderit.

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Sekretar i Përgjithshëm! Atëherë KAS i konsultuar në vend vendosi kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore me numër 17 të datës 6.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Seanca për shqyrtimin administrativ të kësaj kërkesë do të zhvillohet në datë 2 maj 2023 në orën 14:00. Të njoftohen palët. Seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 70

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

